

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6712
E enjte, 22 shtator 2022
çmimi 0.40

Policia arreston shtatë persona lidhur me rastin "Brezovica" | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYETARJA E GJYKATËS SPECIALE, EKATERINA TRENDAFILOVA, KA MBAJTUR KONFERENCË ONLINE PËR MEDIE | FAQE 4-5

GJYKIMI I LIDERËVE TË UÇK-së PRITET TË NISË NË FILLIM TË VITIT 2023



Gjykimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit në Gjykatën Speciale në Hagë pritet të fillojë këtë vit, më së largu deri në fillim të vitit 2023, ka bërë me dije, në një konferencë online për medie, kryetarja e Speciales, Ekaterina Trendafilova. "Është e pritshme që në një

rast të tillë, deri në fund të këtij viti, më së voni në fillim të vitit të ardhshëm, do të fillojë procedura, sepse gjyqtarët janë marrë me shqyrtimin e të gjitha dokumenteve të rëndësishme të rastit", ka thënë Trendafilova, duke shtuar se nuk ka dijeni nëse do të ngrehen aktakuza të reja

AKTUALE



GJERMANIA BASTIS PRONAT E ALEATIT TË PUTINIT | F. 2

DANIMARKA: MARRËVESHJA ME KOSOVËN PËR BURGJET ËSHTË NË FUQI | F. 5

NË VITIN 2021 JANË RAPORTUAR 45 VETËVRASJE DHE 132 TENTATIVA PËR VETËVRASJE | F. 7

EKONOMI



GUVERNATORI MEHMETI PRET PËRFAQËSUESIT E FMN-së, KONFIRMOHET PËRKRAHJA PËR BQK-në | F. 8

MURATI: EKONOMIA E KOSOVËS PO TREGON QËNDRUESHMËRI TË JASHTËZAKONSHME | F. 8

SPORT



'DARDANËT' VAZHDOJNË PËRGATITJET, MURIQI DHE KRASNIQI BESOJNË NË REZULTATE POZITIVE | F. 10

"KORNIZA E RE" E DIALOGUT, KURTI THOTË SE NUK I KOMENTON DOKUMENTET PA AUTOR | FAQE 3



MIRATOHET BUXHETI I PRISHTINËS NË VLERË MBI 105 MILIONË EURO | FAQE 6



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjermania bastis pronat e aleatit të Putinit

Berlin, 22 shtator - Hetuesit gjermanë kanë bastisur pronat e një oligarku rus që dyshohet për evazion fiskal dhe për shkelje të sanksioneve të Bashkimit Evropian, thanë prokurorët. Burimet e AFP-së thanë se pronat e shënjestruara i përkasin miliardërit Alisher Usmanov. Bastisjet u përqendruan në dy prona që thuhet se i përkasin Usmanovit, 69 vjeç, në Miesbah të Bavarisë. Në njoftimin e Policisë, autoritetet nuk emëruan të dyshuarin, por burimet e afërta me hetimin thanë për AFP-në se bëhet fjalë për Usmanovin, aleat i ngushtë i presidentit rus, Vladimir Putin, dhe ish-shef i Federatës

Ndërkombëtare të Skermës. Midis viteve 2017 dhe 2022, i dyshuari ishte akuzuar se kishte fshehur disa miliona euro që i kishte fituar përmes aktiviteteve joligjore, përfshirë përmes ikjes së taksave. E gjithë kjo ishte bërë përmes "rrjetesh komplekse të kompanive dhe korporatave", duke fshehur origjinën e parave, tha Policia gjermane.

Rreth 250 policë u përfshin në bastisje dhe evazioni fiskal vlerësohet se arrin në 550 milionë euro, raportoi revista "Der Spiegel".

Në operacionin policor në total u shënjestruan 24 prona që i përkasin oligarkut rus dhe katër personave të tjerë, thanë



prokurorët në Muni. Usmanov po ashtu akuzohet se ka përdorur fondet e ngrira nën sanksionet e BE-së për të paguar monitorimin e pronave nga

kompani të sigurimeve, thanë prokurorët gjermanë. Katër personat e tjerë dyshohet se kanë ofruar për oligarkun shërbime të vëzhgimit. Mediet gjermane më

herët gjatë këtij viti raportuan se autoritetet kishin konfiskuar jahtin "Dalibar", në pronësi të Usmanovit.

Ky jaht ishte ankoruar në portin e Hamburgut që prej tetorit të vitit 2021 për riparime. Në listën e Sunday Times, Usmanov më 2021 ishte radhitur në vendin e gjashtë në listën e personave më të pasur në botë.

Ai është një prej dhjetëra miliardërve rusë që janë shënjestruar nga sanksionet e Perëndimit, pasi Rusia nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.

Usmanov besohet se aktualisht po jeton në Uzbekistan, raportoi "Der Spiegel".

Borrelli bisedon me liderët e Ballkanit për ndikimin e pushtimit rus të Ukrainës

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Shefi i Politikës së Jashtme dhe Sigurisë, Josep Borrell, tha se ka biseduar me gjashtë liderët e Ballkanit Perëndimor për ndikimin që po ka në rajon dhe botë pushtimi i përvokuar rus i Ukrainës. "BE-ja dhe Ballkani Perëndimor do të qëndrojnë së bashku në përballje me sfidat që sjellë lufta e përvokuar e Rusisë kundër Ukrainës në nivel botëror. BE-ja përfshin Ballkanin Perëndimor në nismat e saj për të zbutur ndikimet e luftës", u tha në njoftimin e lëshuar nga blloku evropian.

Borrell u takua më 20 shtator në Nju Jork me liderët e Ballkanit Perëndimor, teksa në qytetin amerikan po mbahet Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. "Përfaqësuesi i Lartë Borrell dhe liderët e Ballkanit Perëndimor diskutuan se si do të mund të adresojnë së bashku pasojat dëmtoese të kësaj lufte mbi çmimet e ushqimit dhe energjisë dhe të stabilitetit dhe sigurisë në Evropë dhe botë",



thuhet në njoftimin e lëshuar nga blloku evropian.

Borrell u ka premtuar shteteve të Ballkanit Perëndimor se blloku evropian do t'i ndihmojë për të rritur sigurinë energjetike dhe për të adresuar "kërcënimet hibride, përfshirë ato kibernetike".

Qëkur Rusia ka nisur pushtimin e

Ukrainës më 24 shkurt, kriza energjetike është përkeqësuar në Evropë, pasi Moska ka ndërprerë furnizimet me gaz përmes gazsjellësit më të madh për në Evropë.

Blloku ka akuzuar Rusinë se po përdor energjinë si "armë", teksa çmimet botërore të ushqimit po

ashtu janë rritur për shkak të luftës në Ukrainë.

Në takimin në Nju Jork, Kosova u përfaqësua nga presidentja Vjosa Osmani.

Sipas njoftimit të Presidencës së Kosovës, Osmani në takim është shprehur se "askush në rajon nuk duhet t'i shërbejë si satelit" Rusisë,

me qëllim të "destabilizimit të rajonit".

Nga vendet e rajonit, Serbia refuzon që të vendosë sanksione ndaj Rusisë për shkak të pushtimit të Ukrainës, pavarësisht se BE-ja vazhdimisht ka bërë thirrje që Beogradi ta ndëshkojë Moskën.

Pikërisht, lufta në Ukrainë është përmendur disa herë si arsye shtesë që rajoni i Ballkanit Perëndimor të zgjidhë sa më shpejt çështjet e hapura, me qëllim që të parandalohen tensionet.

Bashkimi Evropian ndërmjetëson dialogun mes Kosovës dhe Serbisë që ka për qëllim normalizimin e plotë të raporteve. Vetë Borrell, gjatë rundit të fundit të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë - që u mbajt pas rritjes së tensioneve në veri të Kosovës - tha se në kohën kur Rusia po vazhdon pushtimin e Ukrainës, "nuk është koha për rritjen e tensioneve, është koha të shikohet të gjenden zgjidhje dhe të zgjidhen mosmarrëveshjet e kamotshme".

EMA: Pandemia Covid-19 nuk ka përfunduar

BRUKSEL, 21 SHTATOR - Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) ka njoftuar se rastet dhe vdekjet me koronavirus po bien, por paralajmëroi se "pandemia ende po vazhdon", duke iu bërë thirrje shteteve që të përshpejtojnë programet e imunizimit para stinës së dimrit.

Të dhënat e mbledhura gjatë javëve të fundit "kanë treguar një rënie të numrit të përgjithshëm të rasteve dhe vdekjeve në Evropë të shkaktuara nga sëmundja Covid-19", ka njoftuar kreu për strategji të vaksinave i kësaj agjencie të Bashkimit

Evropian, Marco Cavaleri. "Megjithatë, teksa po afrohet vjeshta, ne duhet të përgatitemi për një valë të re të infektiveve në linjë me tredin e shfaqur nga ky virus në dy vjetet e fundit", ka theksuar Cavaleri gjatë një konference për medie.

Këto deklarata nga EMA-s vijnë pasi presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, gjatë një interviste për CBS tha të dielën se pandemia ka përfunduar në ShBA. "Pandemia ka përfunduar. Ne ende kemi problem me Covid-in. Ne ende duhet të bëjmë shumë punë për këtë gjë... por, pandemia ka përfunduar", ka thënë Biden.

Megjithatë, EMA vlerëson se pandemia ende po vazhdon në kontinentin evropian.

"Është e qartë për mua dhe Cavaleri e bëri shumë të qartë se ne në Evropë ende konsiderojmë se pandemia po vazhdon", ka theksuar shefi mjekësor i EMA-s, Steffen Thirstrup. "Është e rëndësishme që shtetet anëtare të bllokut të vazhdojnë me dhënien e vaksinave" kundër koronavirusit, tha ai.

Javën e kaluar, EMA miratoi vaksinën e parë - një version të modifikuar të vaksinës së Pfizer/BioNTech - që shënjestron llojet shumë



infektuese BA.4 dhe BA.5 të variantit Omicron të koronavirusit.

Në dy vjet e gjysmë që kur u shfaqën rastet e para me Covid-

19 në Kinë sipas të dhënave të Universitetit Johns Hopkins, në botë janë regjistruar mbi 612 milionë raste dhe mbi 6.5 milionë kanë vdekur.

Osmani takon Escobarin, temë diskutimi dialogu Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, në kuadër të vizitës në Nju-Jork, është takuar me këshilltarin në Departamentit Amerikan të Shtetit, Derek Chollet dhe të dërguarin amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar.

Në takim me zyrtarët e lartë amerikanë, presidentja Osmani ka diskutuar për zhvillimet e fundit në rajon dhe më gjerë si dhe për bashkëpunimin e mëtejshëm për ta avancuar integrimin euroatlantik të Kosovës si një parakusht për stabilitet afatgjatë.

Presidentja Osmani shprehu mirënjohjen e saj për mbështetjen e vazhdueshme të ShBA-së, në veçanti përkrahjen e ShBA-së në procesin e dialogut. Ajo theksoi nevojën për të ecur përpara me procesin e dialogut me Serbinë të përqendruar në njohjen reciproke.

Presidentja Osmani potencoi nevojën që Serbia t'i zbatojë obligimet e saj nga marrëveshja për udhërrëfyesin e energjisë dhe nevojën urgjente që të arrihet



sukses sa i përket marrëveshjes për të zhdukurit me dhunë. Me ftesë të presidentit të Nigerit, Mohamed Bazoum dhe

presidentit të Konfederatës Zvicerane, Ignazio Cassis, presidentja Osmani ka marrë pjesë në një konferencë të Fondit

Global për Angazhimin dhe Qëndrueshmërinë e Komunitetit, në të cilën ka konfirmuar përkushtimin e palëkundur të

Republikës së Kosovës për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Presidentja Osmani ka theksuar se bashkëpunimi mes shteteve është i domosdoshëm dhe në funksion të mbrojtjes së atyre që rrezikohen nga grupet e dhunshme ekstremiste dhe organizatat terroriste.

Në këtë konferencë presidentja Osmani ka potencuar se Kosova është mbështetur nga Fondi Global i Angazhimit dhe Rezistencës së Komunitetit ndaj, sipas saj, kësaj radhe shteti i Kosovës ka vendosur të kontribuojë duke e mbështetur Fondin.

Sipas Osmanit, në luftimin e sfidave të përbashkëta duhet qëndruar bashkërisht.

"Bashkëpunimi dhe ndërgjegjësimi qëndron në thelbin e zgjidhjeve të qëndrueshme dhe të gjata ndaj kërcënimeve sistematike të cilat minojnë prosperitetin e shoqërive tona", ka theksuar presidentja Osmani, duke shtuar se vendosmëria dhe këmbëngulja janë rruga jonë përpara.

"Korniza e re" e dialogut, Kurti thotë se nuk i komenton dokumentet pa autor

PRISHTINË, 21 SHTATOR - "Qarkullojnë dokumente të ndryshme, mirëpo unë besoj se nuk është as e dobishme e as drejtë që t'i komentoj ato dokumente që nuk kanë autor, por bëhen për ta matur pulsën e qytetarëve dhe politikanëve", ka thënë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë për medie të mërkurën pas hapjes së "Samitit Digjital" në Prishtinë. Sipas tij, vetëm dokumentet që prodhohen në Bruksel duhet të komentojnë. Gjatë fundjavës u publikua një dokument që thuhej se ishte "korniza e re" e propozuar për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Sipas këtij dokumenti, njohja reciproke nuk është më pjesë e marrëveshjes finale por që, ndër të tjera, Kosovës i garantohen njohjet e pesë vendeve të BE-së.

Kurti ka thënë se normalizimi i raporteve me Serbinë duhet të bëhet me marrëveshje ligjërisht të obligueshme, "ku në qendër duhet të jetë njohja reciproke".

Për "kornizë të re" për dialogun ka folur më 10 shtator edhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Ai ka deklaruar se gjatë vizitës në Beograd të të dërguarit të posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav



Lajçak, atij iu ofrua një dokument, por ai refuzoi që ta pranonte. Më 15 shtator Miroslav Lajçak zhvilloi takim me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe zëvendësin e tij, Besnik Bislimi. Ai tha se qëllimi i vizitës së tij në

Prishtinë është "çuarja përpara" e këtij procesi.

Lajçaku tha se në takim u bisedua për "vazhdimin e dialogut" dhe për takimin e ardhshëm të Kurtit me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Kurti dhe Vuçiq u takuan për herë të fundit në Bruksel më 18 gusht. Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011 dhe ka për qëllim normalizimin e plotë të raporteve. Palët kanë dallime të mëdha sa i përket përfundimit të këtij procesi.

Përdërisa Kosova kërkon që një marrëveshje përfundimtare ta përfshijë njohjen reciproke, Serbia ka thënë se dëshiron një zgjidhje kompromisi, pa specifikuar se çfarë do të nënkuptonte një zgjidhje e tillë.

10 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e

fundit, pas 230 testimeve, janë konfirmuar 10 raste të reja me Covid-19.

Sipas raportit të MSh-së, janë shëruar edhe 13 persona. Raste aktive janë 64. Në 24

orët e fundit 23 qytetarë janë vaksinuar kundër Covidit.





KRYETARJA E GJYKATËS SPECIALE, EKATERINA TREDAFILOVA, KA MBAJTUR KONFERENCË ONLINE PËR MEDIE

Gjykimi i liderëve të UÇK-së pritet të nisë në fillim të vitit 2023

Gjykimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit në Gjykatën Speciale në Hagë pritet të fillojë këtë vit, më së largu deri në fillim të vitit 2023, ka bërë me dije, në një konferencë online për medie, kryetarja e Speciales, Ekaterina Trendafilova. “Është e pritshme që në një rast të tillë, deri në fund të këtij viti, më së voni në fillim të vitit të ardhshëm, do të fillojë procedura, sepse gjyqtarët janë marrë me shqyrtimin e të gjitha dokumenteve të rëndësishme të rastit”, ka thënë Trendafilova, duke shtuar se nuk ka dijeni nëse do të ngrehen aktakuza të reja.

festat e pushimit, bashkë me një ekip shumë të përkushtuar. Gjyqtarët janë shumë kërkuar, kërkojnë shumë që të njohin çdo aspekt të materialeve dhe provave si dhe respektojnë në mënyrë të rreptë çdo afat kohor”, ka thënë Trendafilova, duke shtuar se nuk ka dijeni nëse do të ngrehen aktakuza të reja. “Nuk e di se cilat janë

intencat e prokurorit. Ajo që prokurorët bëjnë është nëse e hetojnë ndonjë krim të lidhur me ngjarjet ose njerëzit e tjerë që gjoja kanë kryer krime që bien në mandatin tonë dhe juridiksionin tonë. Kjo është diçka që unë nuk di. Prokurori do të më njoftojë para se të dalë me ndonjë kërkesë për konfirmim të aktakuzës në

mënyrë që unë të vë njoftimin dhe unë e caktoj edhe gjyqtarin e procedurës paraprake. Natyrisht, nëse kjo ndodh brenda një periudhe të caktuar kohore, aktivitetet e tilla mund të jenë konfidenciale, por deri më tani mund t’ju them se nuk ka asgjë”, ka deklaruar Trendafilova.

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

HAGË, 21 SHTATOR - Kryetarja e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, ka mbajtur të mërkurën në Hagë një konferencë online për medie, në të cilën ka folur në mënyrë kronologjike për ecurinë e proceseve gjyqësore kundër përfaqësuesve të UÇK-së të cilët janë duke u mbajtur në paraburgim nga viti 2020. Kjo konferencë ishte paraparë të mbahej në Gjilan, mirëpo është anuluar pasi ishte paralajmëruar një protestë kundër vizitës së saj nga ana e Partisë Socialdemokrate (PSD), e cila ishte e mbështetur edhe nga disa degë të Organizatës së

Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Duke folur për rastin e liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, kryetarja Trendafilova ka bërë me dije se më së largu deri në fillimin e vitit 2023 pritet të fillojë shqyrtimi kryesor në rastin e katër drejtuesve të UÇK-së. “Është e pritshme që në një rast të tillë, deri në fund të këtij viti, më së voni në fillim të vitit të ardhshëm, do të fillojë procedura, sepse gjyqtarët janë marrë me shqyrtimin e të gjitha dokumenteve të rëndësishme të rastit. Gjyqtari i procedurës paraprake është duke punuar në çdo moment dhe duke angazhuar edhe



Malli pa dokumentacion, majori Rama thotë se ATK-ja do ta ketë përkrahjen e policisë

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Me qëllim të koordinimit të aktivitetëve në fushën e trajtimit të mallit pa dokumentacion, si dhe mungesës në stoqe, sot ekipi i cili menaxhon këtë projekt ka mbajtur takim me palët e interesit.

Në këtë takim Nahit Sharku, zëvendësues i drejtorit të Departamentit për Programe dhe Procedura, foli për përmirësimin dhe përmbushjen tatimore në sektorin e tregtisë me shumicë, duke përfshirë të gjithë faktorët që ndikojnë dhe ndikohen nga ky sektor në mënyrë më të fokusuar dhe më të koordinuar.

Po ashtu, palët e interesit u njoftuan edhe për grupet e synuara për trajtim përmes këtij



projekti, si ajo e industrisë së tekstilit, tregtia me shumicë e produkteve ushqimore, pijeve

dhe duhanit, tregtia me shumicë e artikujve shtëpiakë, tregtia tjetër me shumicë e specializuar,

tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara, tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara dhe të tjera.

Nga ana tjetër, Valbona Ymeri, udhëheqëse e Sektorit të Hetuesisë nga Dogana e Kosovës, tha se si çdoherë jemi të gatshëm t'i bashkërendojmë aktivitetet, pasi që dukuria e kontrabandës është edhe prioritet i institucionit të Doganës.

Majori Blerim Rama, drejtori i Operativës nga Policia Kufitare e Kosovës, ka përgëzuar ATK-në për projektin, duke shtuar se nga ana e policisë si çdoherë do të ofrohet mbështetja dhe asistimi

në çdo aksion.

Nexhmije Krasniqi nga Departamenti Ligjor i OEK-ut ka thënë se çdo nismë e ATK-së do ta gjejë përkrahjen e organizatës sonë pasi që vetëm në këtë mënyrë do të arrijmë të kemi barazi në të bërit biznes.

Në fund të këtij takimi u tha se ekziston ende një numër i konsiderueshëm i tatimpaguesve të cilët kanë problemin e mallit pa dokumentacion si rezultat i blerjeve pa fatura, po ashtu shitje të padeklaruara. Bazuar në të dhënat e përmbushjes gjatë vitit 2021, shihet se dukuria e mallit pa dokumentacion renditet si ndër dukuritë me nivel të lartë të riskut dhe janë identifikuar si aktivitete më me risk.

Danimarka: Marrëveshja me Kosovën për burgjet është në fuqi

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Ministria e Drejtësisë e Danimarkës ka konfirmuar se marrëveshja me Kosovën për burgjet është ende në fuqi. Në një përgjigje dërguar "Radios Evropa e Lirë", nga kjo ministri thanë se Danimarka nuk ka "ndërprerë, nuk është tërhequr apo nuk ka pezulluar" marrëveshjen për burgjet. "Çdo raportim në medie që sugjeron të kundërtën është i bazuar në keqkuptim", u tha në përgjigjen dërguar REL-it.

Më 19 shtator Ministria e Drejtësisë e Kosovës tha se

kishte marrë konfirmim nga pala daneze që raportimet lokale nga një media në Danimarkë ishin bazuar "në keqkuptim", por MD-ja shtoi se "pritet që kjo gjë të sqarohet tutje".

Më 27 prill Kosova dhe Danimarka u pajtuan që në Kosovë të vijnë 300 të burgosur nga Danimarka, pasi ky shtet po tenton ta shkurtojë mbipopullimin e burgjeve.

Fillimisht, në dhjetorin e vitit të kaluar, dy shtetet u pajtuan që të merren me qira 300 qeli burgju në këmbim të një tarife

vjetore prej 15 milionë eurosh. Marrëveshja ka një kohëzgjatje prej dhjetë vjetësh dhe Kosova pritet të përfitojë 210 milionë euro. "Një shumicë e madhe në Parlamentin danez e ka miratuar marrëveshjen në fillim të këtij viti dhe bashkëpunimi me Kosovën për planifikimin dhe realizimin e projektit po vazhdon", tha Ministria daneze e Drejtësisë në përgjigjen dërguar REL-it.

Sipas marrëveshjes, të burgosurit e huaj do të dërgohen në fillim të vitit 2023 në një burg në qytetin e



Gjilanit. Pasi ta kenë vuajtur dënimin, ata do të dëbohen nga Kosova.

Danimarka dëshiron që të huajt që kryejnë vepra penale

të dënohen me dëbim nga shteti. Ky shtet planifikon që ta transferojë menaxhimin e të huajve përtej kufijve të Bashkimit Evropian.

Trendafilova flet për protestën e paralajmëruar të PSD-së

Më tutje, kryetarja e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, ka folur për protestën e paralajmëruar nga PSD-ja kundër vizitës së saj në Kosovë, përkatësisht në Gjilan. Në këtë kontekst, Trendafilova ka thënë se Gjykata Speciale dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) janë plotësisht të pavarura nga njëra-tjetra. "Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) dhe Prokurori i Specializuar (ZPS) janë plotësisht të pavarura nga njëra-tjetra dhe jemi marrë vetëm me përgjegjësi individuale dhe jo me përgjegjësi të organizatave. Siç e shihni, DhSK-ja fokusohet vetëm në mandatin e vet. Kam parë në medie që ka kritika sa i përket punës së gjykatës. Gjithashtu, ka njerëz që nuk besojnë në mandatin e DhSK-së si gjykatë. Ne nuk merremi me vendime politike, nuk angazhohemi në argumente për çështjen e rasteve që tashmë janë trajtuar nga gjyqtarët. Duhet ta përmbushim mandatin tonë sipas Kushtetutës dhe ligjit për Dhomat e Specializuara, duke siguruar procedura të drejta, të pavarura dhe të paanshme.

Vendimet dhe aktgjykimet do të flasin. Ky është edhe qëllimi i vizitës sime për t'ju informuar shkurtimisht se çfarë po ndodh. Qëllimi është të angazhohemi në një shkëmbim transparent dhe të hapur të pikëpamjeve", ka thënë Trendafilova, duke shtuar se qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të protestojnë. "Normalisht, populli i Kosovës ka të drejtë të protestojë, por më duhet të theksoj se unë nuk diskutoj as nuk lidhem me politikë sepse, e përsëris, unë nuk jam politikane. Asnjë gjyqtar në asnjë institucion nuk është politikan, madje jam mjaft inorjante në politikë", ka thënë Trendafilova.

Ajo ka theksuar se anulimin e vizitës fizikisht aspak nuk e ka bazuar në çështjet e sigurisë personale. "Normalisht që unë do të vij përsëri, kur nuk mund të them, por ju do të njoftoheni. Aspak nuk jam frikësuar për sigurinë time personale në këto vizita që unë i bëj, vetëm të tregoj mbarëvajtjen e punës së Dhomave të Specializuara", ka thënë Trendafilova.

Gucati dhe Haradinaj e kanë apeluar vendimin e Speciales

Kryetarja e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, në këtë konferencë për medie ka

Trendafilova për nismën e Edi Ramës kundër raportit të Dick Martyt: Nuk jam politikane

Kryetarja e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, në një intervistë për "RTS" ka folur për iniciativën e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, përmes së cilës synohet distancimi i Këshillit të Evropës nga raporti i Dick Martyt.

Trendafilova ka thënë se është në dijeni për një nismë të tillë të Kuvendit të Shqipërisë, por nuk ka pranuar të thellohet në komentim meqë ka theksuar se nuk është politikane. Më tutje, ajo ka treguar se Gjykata Speciale punon bazuar në procedurat paraprake. "Sigurisht që nisma e Kuvendit të Shqipërisë i di të gjithë, por dua t'ju kujtoj parimet bazë - gjyqtarët nuk janë politikane, as unë nuk jam

politikane. Kam njohuri në fushën e drejtësisë. Dhomat e Specializuara nuk kanë instrumente ligjore për t'u marrë me raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Neni 1 i Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë mandaton që mandati ynë duhet të lidhet me kontekstin e atij raporti dhe thuhet qartë se ne si Dhoma monitorojmë dhe deklarojmë se çfarë është vendosur në procedurë paraprake. Nuk punojmë në kuadër të raportit, por vetëm në kuadër të aktakuzave", ka thënë Trendafilova.

Me 125 vota për dhe asnjë abstenim deputetët e pranishëm në seancën e Kuvendit të Shqipërisë më 21

korrik e kanë miratuar rezolutën kundër akuzave për trafikim të organeve në Kosovë dhe Shqipëri gjatë luftës në Kosovë.

Gjykata Speciale është krijuar mbi bazën e raportit të Dick Martyt, ku nga nëntori i vitit 2020 janë duke u mbajtur në paraburgim drejtuesit kryesorë të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi qysh në daljen e parë para trupit gjykues janë deklaruar të pafajshëm në lidhje me akuzat e prokurorisë. Përpos tyre, në qendrën e paraburgimit në Hagë janë duke u mbajtur edhe Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Sali Mustafa dhe Pjetër Shala.

njoftuar se drejtuesit e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, e kanë kundërshtuar vendimin e Dhomave dhe për këtë i janë drejtuar Apelit. Për këtë rast,

Gjykata Speciale ka shpallur vendim më 18 maj 2022 dhe i ka dënuar me katër vjet e gjysmë burgim dhe 100 euro gjobë. Trendafilova e ka cilësuar rastin e Guccati dhe të Haradinaj si shumë të rëndësishëm për

Gjykatën Speciale. "Edhe pse nuk ka pasur krime kundër njerëzimit dhe krime lufte, përsëri është një rast shumë i rëndësishëm për Dhomat e Specializuara", është shprehur Trendafilova.

Miratohet buxheti i Prishtinës në vlerë mbi 105 milionë euro

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Kuvendi Komunal i Prishtinës ka miratuar të mërkurën buxhetin e komunës që do ta ketë vlerën mbi 105 milionë

euro. Njëzetë e gjashtë asamblistë kanë votuar pro këtij buxheti, nuk ka pasur votë kundër dhe as abstenim.

Në seancën e kuvendit

komunal kanë munguar asamblistët e Vetëvendosjes, të AKR-së dhe tre të AAK-së, të cilët e kanë bojkotuar këtë pikë të rendit të ditës, me

arsyetimin se ekzekutivi nuk e ka anuluar projektin "Zyra e Arkitektit" të kërkuar nga opozita. Votimi i buxhetit shpang zgjedhjet për kuvend komunal.



Hamza pret në takim ministrin e Kulturës, flasin për projektet në komunën e Mitrovicës

MITROVICË, 21 SHTATOR - Në serinë e vizitave nëpër komuna, ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, është takuar me kryetarin e Mitrovicës, Bedri Hamza.

Çeku dhe Hamza kanë diskutuar për projektet infrastrukturore që kanë mbetur të zvarritura ndër vite dhe ato të reja që sportistët, artistët, të rinjtë e qytetarët e kësaj zone të kenë hapësira të dinjitetshme për ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

Në takimin e tyre u theksua se ndër projektet që përbën prioritet për MKRS-në është stadiumi "Adem Jashari".

Ministri Çeku ka njoftuar që po punohet me intensitet të shtuar që të zgjidhen problemet e kamotshme në këtë projekt në mënyrë që të vazhdoen punimet sa më parë.

Në këtë takim është folur edhe për mundësinë e investimeve në qendrën sportive "Fatime Xhaka".

Të dy janë pajtuar që të kenë koordinim të mirëfilltë ndër-institucional për hapat e radhës.

Si projekte potenciale, ministri Çeku ka përmendur shtëpinë e shahut, ndërtimin e sallës së xhudos dhe disa projekte të tjera për të cilat do të ketë koordinim me të gjitha palët në vitet në vazhdim. Ministri Çeku edhe në këtë takim ka vënë theksin te rëndësia që projektet të jenë sa më cilësore dhe t'i plotësojnë të gjitha kriteret në mënyrë që gjatë implementimit të projekteve të mos shfaqen probleme siç ka ndodhur në shumicën prej tyre deri tani. Në fund ata kanë diskutuar për programet shtetërore, art në shkollë dhe sport në shkollë që pritet të zhvillohen nga viti i ardhshëm në gjithë vendin, ndërsa ministri Çeku ka marrë mbështetje nga komuna e Mitrovicës.



Komuna e Gjilanit instalon GPS-të në veturat zyrtare



GJILAN, 21 SHTATOR - Komuna e Gjilanit të mërkurën ka përfunduar projektin e instalimit të pajisjeve digjitale të navigimit, përkatësisht sistemin GPS në të gjitha automjetet e saj zyrtare, për ta monitoruar kështu përdorimin e tyre, përkatësisht për t'i mënjanuar mundësitë e keqpërdorimit eventual.

Kryetari i komunës, Alban Hyseni, ka thënë se këto pajisje janë instaluar në 30 vetura dhe përmes tyre tash do të jetë më lehtë të monitorohet përdorimi i automjeteve dhe parandalimi i keqpërdorimit të rastësishëm të automjeteve të komunës, po edhe mirëmbajtjes së tyre. "Ky është një avancim tutje në ruajtjen e të mirës publike dhe pasurisë që u takon edhe qytetarëve dhe jo vetëm atyre që janë në punë në kuadër të komunës", ka thënë Hyseni. Për më tepër, ai ka nënvizuar se

punët e tilla duken të vogla, por kanë një efekt të madh dhe janë shumë të rëndësishme, sepse automjetet ruhen më shumë se më përpara, kursehet buxheti i komunës, ndërkohë sigurohemi që të gjitha veturat, përveç atyre që kanë leje, kthehen në autopark dhe nga këtu pastaj shpërndahen nëpër drejtoritë përkatëse dhe përdoren për qëllimet e destinuara.

"Njëherësh, përdorimi i këtij programi është i lehtë, përmes një kompjuteri dhe një softueri të thjeshtë dhe përparësia e tij është se detekton edhe shpejtësinë e lëvizjes së veturave tona në rrugë", ka thënë Hyseni.

Ky projekt është realizuar me një investim të vogël, dikur rreth 3 000 euro, por që si aparatura kanë efekt shumë të madh për monitorimin e përdorimit të veturave zyrtare.

Komuna e Prizrenit dhe USAID-i vazhdojnë bashkëpunimin për projektin "Kontrata sociale"

PRIZREN, 21 SHTATOR - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur të mërkurën në takim zyrtarët e USAID-it, me të cilët ka biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit për realizimin e projektit "Kontrata sociale".

Gjatë takimit është diskutuar për hulumtimin e bërë për tre

vitet e kaluara. Me këtë rast janë prezantuar edhe rreziqet, barrierat dhe rekomandimet.

Kryetari Totaj ka thënë se komuna e Prizrenit i vlerëson të gjeturat e këtij hulumtimi, pasi ato do ta lehtësojnë edhe më shumë kryerjen e punëve në të mirë të të gjithë qytetarëve të Prizrenit.

Ndërsa zyrtarët e USAID-it u treguan të gatshëm t'i ndihmojnë zyrtarët e komunës së Prizrenit në pikat ku interesimi është më i madh dhe u zotuan që përmes konsulentëve të tyre do t'i përkrahin zyrtarët komunalë që të mos kenë vështirësi në ushtrimin e detyrave.



Policia arreston shtatë persona lidhur me aksionin "Brezovica"

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Prokuroria Themelore në Ferizaj ka njoftuar se në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Rënda (DHKR) në Prishtinë, në bazë të urdhërësës së lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj për kontrollin e shtëpive dhe objekteve përcjellës, të mërkurën ka realizuar aksionin "Brezovica", i cili është vazhdimësi i rasteve të

mëhershme, me ç'rast gjatë këtij aksioni janë kontrolluar dhe bastisur njëmbëdhjetë lokacione të ndryshme, konkretisht tetë lokacione në qytetin e Prishtinës, dy në Podujevë dhe një në Fushë-Kosovë.

Në kuadër të këtij aksioni janë arrestuar shtatë persona të dyshuar dhe me vendim të Prokurorit të Shtetit janë ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orësh për shkak të dyshimit se kanë kryer veprat penale "Marrja e ryshfetit", nga neni 421 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës

"Dhënia e ryshfetit", nga neni 422, "Fajdeja" nga neni 331 dhe "Ushtrimi i ndikimit" nga neni 424 i Kodit Penal i Republikës së Kosovës.

Po gjatë këtij aksioni janë sekuestruar prova të ndryshme materiale për të cilat Prokuroria Themelore në Ferizaj do të informojë në vazhdimësi.

Ndaj personave të dyshuar Prokuroria Themelore në Ferizaj, brenda afatit ligjor, pritet të parashtrijë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në Gjykatën Themelore në Ferizaj.



Në vitin 2021 janë raportuar 45 vetëvrasje dhe 132 tentativa për vetëvrasje

**EPOKA
ERE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Shëndeti mendor ka qenë një nga temat më të diskutuara që prej përhapjes së pandemisë me Covid-19. Kjo krizë globale shëndetësore ka përkeqësuar çrregullimet e ankthit, depresionit dhe aspektet e tjera të shëndetit mendor, duke rritur normat e zakonshme të këtyre problemeve të shëndetit mendor në 25 për qind deri në vitin 2022. Edhe Kosova nuk mbeti e paprekur.

Kjo temë është trajtuar në nismën për Bashkëpunim për Komunitet, që është lansuar përmes partneritetit ndërmjet Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe misionit të USAID-it në Kosovë dhe, si e tillë, synon gjetjen e zgjidhjeve konkrete dhe të qëndrueshme për mbështetje të shëndetit mendor për qytetarët në Kosovë.

Pra kjo nismë është një instrument i krijuar për ta promovuar dialogun dhe bashkëpunimin ndërsektorial, duke bashkuar aktorë të rëndësishëm nga sektorë të ndryshëm si: përfaqësues të



institucioneve publike, sektorit privat, medias dhe shoqërisë civile, në një agjendë të përbashkët për zgjidhjen e një problemi të caktuar shoqëror.

Udhëheqësi i Programit për Angazhim Qytetar nga radhët e KCSF-së, Dren Puka, ka thënë se premisa për këtë qasje bazohet duke ditur se çështjet më komplekse sociale nuk mund të zgjidhen të izoluar, por kërkojnë bashkimin e ideve dhe burimeve

nga qytetarët, shoqëria civile, sektori privat, qeveria dhe media. "Shëndeti mendor është një e drejtë themelore e njeriut, prandaj Kosova duhet të ketë strategji të përbashkëta, efektive dhe të realizueshme për të promovuar, mbrojtur dhe rivendosur shëndetin mendor", ka thënë Puka.

James Evans Butler, ushtruesi i detyrës së drejtorit të Zyrës për Demokraci dhe Qeverisje në

USAID në Kosovë, ka theksuar se nisma për bashkëpunim për komunitete është një dialog ndërmjet sektorit privat, shoqërisë civile, medieve dhe përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës për t'i identifikuar çështjet e nivelit komunitar dhe që kërkojnë zgjidhje të udhëhequra në nivel lokal.

Pjesëmarrësit që morën pjesë në takim theksuan gatishmërinë e tyre për t'u angazhuar në çështjet

që kanë të bëjnë me komunitetin e tyre.

Gent Bakija nga kompania "Ujë Rugovë" tregoi se si kanë vendosur ta mbështesin organizatën "Linja e Jetës" për ofrimin e shërbimeve emergjente për parandalimin e vetëvrasjeve dhe se janë të gatshëm ta vazhdojnë këtë bashkëpunim.

Ndërkaq Erjona Gjokolli, gazetare në "Klan Kosova", përmendi rolin e medias në ngritjen e vetëdijes rreth kujdesit ndaj shëndetit mendor, por edhe faktin se ka personel shëndetësor të fushës që hezitojnë të marrin pjesë në emisionet që e ofrojnë hapësirën falas për komunikim me publikun.

Sipas statistikave zyrtare të Policisë së Kosovës, që nga viti 2001 në Kosovë janë vetëvrasur më shumë se 1 000 persona, ndërsa janë regjistruar mbi 4 000 tentativa për vetëvrasje. Vetëm në vitin 2021 janë raportuar 45 vetëvrasje dhe 132 tentativa për vetëvrasje. Një nga mënyrat më efektive për të ofruar shërbime emergjente për t'i parandaluar vetëvrasjet konsiderohen se janë linjat emergjente telefonike për mbështetje.

Mobilizohen institucionet për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF) dhe Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit kanë filluar serinë e punësive për implementimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Qëllimi i punësive është sensibilizimi, mobilizimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme për fëmijët. Ato janë iniciuar edhe si pasojë e gjendjes tejte të rënduar të drejtave të fëmijëve dhe

specifikisht mbrojtjes adekuatë të fëmijëve viktime të formave të dhunës dhe abuzimit.

Punëtoritë synojnë promovimin e Ligjit për Mbrojtje të Fëmijës, të hyrë në fuqi prej dy vjetësh dhe njohjen e secilit profesionist me përgjegjësitë që dalin nga ligji, bazuar në mandatin e tyre institucional.

Përmes tyre do të përfitojnë mbi 500 profesionistë nga të gjitha komunat të mandatuar për të punuar në mbrojtje të fëmijëve nga drejtoritë e ndryshme komunale, qendrat për punë sociale, shkollat, qendrat e mjekësisë familjare, stacionet policore,

gjykatat, prokuroritë dhe organizatat joeveritare.

Po ashtu, KOMF dhe ZQM/ZKM kanë filluar hartimin e programeve të trajnimit për akreditim për zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Përmbajtja e programeve do të jetë një aset edukativ i munguar në fushën e mbrojtjes së fëmijës, veçanërisht në lidhje me Ligjin e Mbrojtjes së Fëmijës, që është i pari i këtij lloji në Kosovë dhe i cili sjell shumë risi dhe aspekte që kërkojnë vëmendjen e shtuar dhe koordinimin institucional për zbatimin e tij në praktikë.

Kjo iniciativë mundësohet në kuadër të projektit "Fuqizimi i



akterëve të shërbimeve sociale për të ofruar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet e

cenueshme në Kosovë" dhe mbështetet nga UNICEF-i në Kosovë në partneritet me USAID-in.

Qeveria ndan 19 milionë euro për subvencionimin e energjisë elektrike

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e fundit ka miratuar vendimin për ndarje të mjeteve buxhetore në vlerë prej 19 milionë eurove lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike në kuadër të masës 3.7 - Mbështetje për tejkalimin e krizës energjetike. Mjetet e ndara do të përdoren për subvencionimin e energjisë elektrike për konsumatorët fundorë me qëllim të uljes së ndikimit të tarifave të energjisë, e cila do të reflektohet në faturat e konsumatorëve. Po në kuadër të masës 3.7 -

Mbështetje për tejkalimin e krizës energjetike janë ndarë 6 milionë euro me qëllim të subvencionimit të zbatimit të masave të efikasitetit të energjisë. Qeveria ka miratuar edhe vendimin për ndalimin e eksportit dhe rieksporit të produkteve të drurit si lëndë djegëse. Ky ndalim është i përkohshëm dhe në përputhje me Tarifën e Integruar të Kosovës (TARIK) të vitit 2022. Po në këtë mbledhje të qeverisë është aprovuar edhe vendimi për dyfishimin e pagesës për

përfituesit e skemës së ndihmës sociale për muajin shtator 2022 në kuadër të zbatimit të masës 3.2 - Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Me vendim të qeverisë janë shpallur me interes të veçantë publik pronat e paluajtshme të cilat janë të nevojshme për realizimin e "Projekteve infrastrukturore për interes publik" në zonat kadastrale: Bërnjak dhe Jasenovik i Epërm në komunën e Zubin Potokut.



Guvernatori Mehmeti pret përfaqësuesit e FMN-së, konfirmohet përkrahja për BQK-në



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka pritur të mërkurën në takim drejtues të lartë të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të udhëhequr nga zëvendës drejtori menaxhues i Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bo Li.

Guvernatori Mehmeti e ka informuar zëvendës drejtorin e FMN-së, Li, dhe përfaqësuesit e FMN-së, për performancën e mirë të sektorit financiar në Kosovë, në veçanti atij bankar dhe ka përmendur rëndësinë e këtij sektori në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit. Guvernatori Mehmeti, po ashtu, ka shpalosur pikëpamjet e Bankës Qendrore lidhur me zhvillimet

makroekonomike në vend si dhe rolin e sektorit financiar si kontribuues kyç në financimin e ekonomisë. Mehmeti ka falënderuar Li dhe ka shprehur vlerësimin më të lartë ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar për përkrahjen e vazhdueshme të Republikës së Kosovës, në përgjithësi dhe të BQK-së në veçanti, përmes ofrimit të asistencave teknike dhe ngritjen e kapaciteteve të

BQK-së me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të institucionit. Në të njëjtën kohë, guvernatori ka shprehur përkushtimin e BQK-së për të qenë partner i besueshëm i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe për vazhdimin e bashkëpunimit në të gjitha aspektet. Zëvendës drejtori menaxhues Bo Li ka përgëzuar guvernatorin Mehmeti për ruajtjen e stabilitetit financiar

në këtë kohë jo të favorshme ekonomike dhe ka theksuar rëndësinë e përdorimit të mjeteve mbikëqyrëse për fuqizimin e sektorit financiar. Gjithashtu, zëvendës drejtori Li ka riafirmuar zotimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për përkrahje të mëtejme dhe ka kërkuar që të mirëmbahet dhe ruhet pavarësia e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Murati: Ekonomia e Kosovës po tregon qëndrueshmëri të jashtëzakonshme

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se, pavarësisht prej sfidave të vazhdueshme globale, ekonomia e vendit tonë po tregon qëndrueshmëri të jashtëzakonshme duke vazhduar zgjerimin edhe në tremujorin e dytë të këtij viti. "Kjo vërehet edhe në trendin e qarkullimit të bizneseve në vend. Si qeveri kemi zhvilluar fushatën e vaksinimit më efektiven në rajon, gjë që ka mundësuar heqjen më të

shpejtë të kufizimeve dhe hapjen e tërësishme të ekonomisë. Kemi subvencionuar çmimin e energjisë elektrike, gjë që mundëson bizneset tona të jenë më konkurrense dhe ta rrisin eksportin. Kemi mbështetur prodhuesit për zgjerimin e kapaciteteve të tyre, duke subvencionuar 20 për qind të vlerës së kredisë investuese", ka thënë Murati të mërkurën, duke shtuar se si qeveri kanë rritur subvencionet në bujqësi duke trefishuar mbështetjen për

grurin e duke rritur mbështetjen për prodhimet dhe kulturat e tjera. "Kemi miratuar e shpërndarë pako masash, më shumë se cilado qeveri tjetër, për t'i mbështetur familjet në nevojë e rritur fuqinë e tyre blerëse e shumë e shumë masa e veprime të tjera, çdoherë në shërbim të mbështetjes së ekonomisë e bizneseve për ta rritur prodhimin, eksportet dhe punësimin", ka theksuar Hekuran Murati, ministër i Financave, Punës dhe Transfereve.



Khorrhia Meloni, provokatorja politike që mund të bëhet kryeministrja e parë e ekstremit të djathtë në Itali



Nga: Julia KHREBTAN-HÖRHAGER & Evgeniya PYATOVSKAYA

Në vjeshtën e vitit 1922, Benito Mussolini, themeluesi ambicioz dhe karizmatik i Partisë Fashiste, u bë kryeministri më i ri i Italisë. Ai mori pushtetin pasi një marshimi në Romë, duke sjellë një periudhë të errët të sundimit totalitar. Një shekull më pas, Italia duket se do të drejtohet sërish nga një udhëheqëse e ekstremit të djathtë.

Të dielën e ardhshme, votuesit pritet të si kryeministren e re Khorrhia Melonin, drejtuesen e partisë Fratelli d'Italia, Vëllezërit Italianë, një parti prejardhja e së cilës është tek fashistët e Musolinit. Shumë italianë dhe evropianë janë të shqetësuar me të drejtë.

Ngjitja e saj e mundshme në krye të vendit, vjen në një kohë delikate për Italinë, vend idëmtuar jo pak nga problemet ekonomike të kohëve të fundit, inflacioni i lartë dhe kriza e emigracionit. Po ashtu, ajo ngre pikëpyetje të pakëndshme mbi idenë e identitetit dhe unitetit evropian.

Për më tepër, është një simptomë e gjendjes së keqe politike në Itali, por edhe e valës populiste që ka nisur të ketë sërish sukses në mbarë botën. Po kush është

Khorrhia Meloni? Ajo është akuzuar si një provokatore politike. Si një nacionaliste krenare, me qëndrime shumë të ashpra kundër emigrantëve, dhe që flet vazhdimisht për mbrojtjen e Italisë nga "islamizimi".

Nga ana tjetër e paraqet veten si mbrojtëse e vlerave tradicionale familjare, duke e politizuar Krishterimin dhe amësinë, si gurët e themelit të identitetit autentik kombëtar italian. Në një fjalim të vitit 2019, ajo tha: "Unë jam Khorrhia. Jam një grua, nënë, jam italiane, dhe jam e krishterë!".

Por Meloni është një kameleon politik. Ajo e ndryshon strategjinë sa herë që kjo është politikisht e dobishme për të. Kur ishte më e re e admironte hapur Musolinit, dhe e konsideronte atë një politikan të mirë. Por e pyetur në prag të zgjedhjeve të 25 shtatorit, nëse ishte dakord që udhëheqësi fashist ishte i keq për Italinë, ajo tha "Po".

Me kalimin e viteve, ka shprehur admirim për liderë të konsideruar nga shumë analistë si ultra nacionalistë, si Vladimir Putin në Rusi, Viktor Orban në Hungari dhe Marin Lë Pen në Francë. Po ashtu, ajo është përpjekur të pozicionohet si e lidhur me konservatorizmin e Partisë Konservatore në Britani dhe Partinë Republikane në

SHBA

Kohët e fundit, Meloni është përpjekur të distancohet nga mbështetja e mëparshme ndaj Rusisë dhe Kinës, dhe të ritheksojë gatishmërinë e saj për t'i shërbyer me atdhetarizëm vendit të saj. Dhe mesa duket ky truk ka funksionuar. Aleanca e ekstremit të djathtë e Fratelli d'Italia e Melonit dhe partisë që kanë të njëjtën qasje, Lega dhe Forza Italia, synojnë të fitojnë shumicën absolute në parlamentin e ri.

Por më shumë ka spikatur partia e Melonit. Sondazhet tregojnë se ajo do të fitojë çerekun e të gjitha votave. Një rritje e jashtëzakonshme. Nga pak më shumë se 4 për qind në vitin 2018, në mbi 25 për qind këtë vit. Kjo trajektore sugjeron që ose kjo parti ka hequr dorë nga lidhjet e saj historike me fashizmin, apo që shumë italianëve nuk u intereson më kjo gjë.

Fratelli d'Italia është një pasardhëse e partisë Lëvizja Sociale Italiane, e formuar nga mbështetësit e Musolinit pas Luftës së Dytë Botërore. Meloni është përpjekur të krijojë një lloj distance me të kaluarën, duke deklaruar se e djathta italiane e konsideron fashizmin si një dukuri të kufizuar në historinë e Italisë. Po ashtu ajo ka shfrytëzuar ndjenjat kombëtare të pasigurisë dhe ankthit, të

shkaktuara nga krizat e shumta me të cilat është përballur vendi gjatë 2 viteve të fundit.

Këtu përfshihet pandemia e Covid-19 që goditi rëndë Italinë, dhe krizat e mëdha humanitare ende të pazgjidhura, të shkaktuara nga migrimi masiv përmes Detit Mesdhe, ku Italia është vendi kryesor pritës i emigrantëve që zbarkojnë në Evropë. Ndërkohë, ky vend po përballlet me një inflacion në rritje, dhe një krizë energjetike të vazhdueshme, të nxitur nga lufta e Rusisë në Ukrainë dhe strategjia e Putinit për ta përdorur gazin e saj si një armë kundër Bashkimit Evropian.

Përballë këtyre krizave, Meloni e ka pozicionuar veten si njeriu që do ta "shpëtojë" Italinë. Historia ka vërtetuar se në kohëra të pasigurita, liderët karizmatikë ultra-nacionalistë priren të dalin mirë në zgjedhje. Me një formulë të njohur të vendosjes së Italisë "në plan të parë", euroskepticismi, ksenofobia dhe islamofobia e Melonit – të ripaketuara si patriotizëm – kanë fituar shumë popullaritet tek italianët.

Por sukcesi i Fratelli d'Italia, nuk ka të bëjë vetëm me Melonin. Ana e kundërt e suksesit të saj, është dështimi i partive të tjera, dhe kaosi i shkaktuar nga rënia e qeverisë që preku shumë nga partitë që konkurrojnë kundër

saj. Zgjedhjet e parakohshme në Itali pasuan dorëheqjen e kryeministrit Mario Draghi, një ekonomist i admiruar në arenën ndërkombëtare me nofken "Super Mario" për shkak të menaxhimit mbresëlënës që i bëri krizës së eurozonës kur ishte kreu i Bankës Qendrore Evropiane.

Draghi drejtoi një koalicion të gjerë, por u detyrua të jepte dorëheqjen në korrik, në mesin e një krize ekonomike dhe politike të thelluar, kur disa partnerë të koalicionit u thyen kundër kryeministrit. Italia ka pasur historikisht shumë probleme lidhshme me koalicionin e saj politik. Sistemi politik siguron vetëm qeverisje me koalicion.

Dhe kjo nënkupton shpesh qeverisje nga një grupim partish, axhendat dhe vizionet e të cilave mund të jenë drastikisht të ndryshme, madje ndonjëherë gati reciprokisht përjashtuese.

Rënia e qeverisë Draghit ka dëmtuar shumë parti në të gjithë spektrin politik, përfshirë Lëvizjen 5-Yjet dikur shumë popullore.

Partitë politike që po përfitojnë nga ky kaos politik kanë qenë kryesisht ato të djathta. Meloni ka garuar në këtë fushatë me sloganin "Pronta a Governare" (Gati për të qeverisur!). Por tani pyetja është nëse Italia është gati për Melonin si kryeministër. / "The Conversation" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT

QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

'Dardanët' vazhdojnë përgatitjet, Muriqi dhe Krasniqi besojnë në rezultate pozitive

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka vazhduar me seancat stërvitore edhe në ditën e tretë të grumbullimit për dy ndeshjet e fundit të edicionit të sivjetmë në Ligën e Kombeve kundër Irlandës së Veriut më 24 shtator dhe kundër Qipros më 27 shtator. Përzgjedhësi Alain Giresse ka vendosur që gjatë ditës së mërkurë të punojë me futbollistët në dy seanca, ku paradite është punuar në Kampin Nacional në Hajvali, derisa pasdite është mbajtur stërvitja në stadiumin "Fadil Vokrri". Në dispozicion kanë qenë të gjithë futbollistët e paraparë të cilët kanë punuar me intensitet dhe përkushtim, teksa kapiteni Amir Rrahmani ka stërvitur i diferencuar në shoqëri të trajnerit të fitnesit, pasi ka arritur më vonë në grumbullim. Për të njëjtat arsye, me intensitet më të ulët ka stërvitur edhe portieri Arijanet Muriç. Atmosfera në ekipin përfaqësues është shumë e mirë, derisa motivi të futbollistët për ta përmbyllur këtë edicion me rezultate pozitive është maksimal. Një nga futbollistët me formën më të mirë, Vedat Muriqi, beson se

Kosova, përkundër mungesave të rëndësishme në këto dy ndeshje, do të arrijë të marrë rezultate pozitive. "Po përgatitemi maksimalisht për ndeshjen kundër Irlandës së Veriut. Sigurisht se do të udhëtojmë për fitore. Në Prishtinë kemi fituar dhe e dimë se çfarë na pret atje. Atje presim të ketë shumë shikues, ku të bashkuar do të na sulmojnë të gjithë, por edhe ne kemi kualitetet tona dhe ashtu siç e kemi fituar ndeshjen e parë, besoj se do ta fitojmë edhe të dytën", ka theksuar Muriqi. Ai thotë se Kosova ka një ekip të mirë dhe mungesat do të mbulohen me lojtarë të tjerë. "Shumica e lojtarëve jemi që po luajmë nëpër ekipet tona. Edhe pse kemi mungesa besoj se ata lojtarë që do ta kenë rastin të luajnë në pozitë e atyre që mungojnë, do ta japin maksimumin. Është me rëndësi të kenë një sistem bazë që për momentin e kemi dhe kur e ke sistemin, pavarësisht kush hyn apo kush del nuk krijon shumë dallim", ka shtuar sulmuesi i Mallorcas, i cili në këtë edicion ka shënuar tre gola në La Liga. Ai vë në pah shpirtin luftarak si pikën më të fortë të "Dardanëve".



"Ne në asnjë lojë nuk e kemi fituar me rezultat bindës apo me posedim të topit dhe gjuajtje, por kemi luftuar dhe kemi fituar me shpirt luftarak. Edhe irlandez-veviorët janë me mentalitet si në të Kosovës dhe besoj se do të bëhet një lojë e fortë, por ne me armën tonë kryesore që e kemi shpirtin luftarak do të shkojmë atje dhe ta japim maksimumin", ka nënvizuar Muriqi.

E futbollisti i Llapit, Ilir Krasniqi, i cili për herë të parë ndodhet i grumbulluar me ekipin kombëtar, është shprehur i lumtur që përzgjedhësi Alain Giresse e ka vlerësuar formën e tij në këtë edicion. "Jam mjaft i lumtur që jam këtu dhe për ftesën nga trajneri. Më kanë pritur ngrohtë mua dhe dy lojtarët e tjerë të Superligës. Atmosfera është e mirë, madje shumë më e mirë sesa që e kam

menduar. Shpresoj të vazhdojmë kështu. Kjo po tregon se ndoshta në të ardhmen do t'u jepet mundësia edhe më shumë lojtarëve të Superligës siç jemi në këtë grumbullim. Shpresojmë të rritet ky numër në të ardhmen. Pritet gjithmonë janë maksimale, besoj se do t'i fitojmë pikët e plota, edhe pse e dimë se do të jetë e vështirë, por shpresojmë më të mirën", ka theksuar Krasniqi.

Trajneri i Irlandës së Veriut paralajmëron fitore ndaj Kosovës



BELFAST, 21 SHTATOR - Irlanda e Veriut ende nuk ka shijuar fitore në Ligën e Kombeve, por një gjë

të tillë trajneri Ian Baraclough është i vendosur ta bëjë në ndeshjen ndaj Kosovës. "Ne

jemi vetëm në gjysmë të rrugës së ciklit tonë, po e ndërtojmë ekipin për kualifikimet e 'Euro 2024'. Krejt e dinë se në qershor ishim të pafuqishëm. Tash synojmë ta mbyllim kampanjën e Ligës së Kombeve sa më lart dhe më pas të shkojmë në shortin e Evropianit në tetor", ka thënë Baraclough. Në ndeshjen e parë të zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, Kosova e kishte mposhtur Irlandën e Veriut (3-2). Përballja në mes të Irlandës së Veriut dhe Kosovës zhvillohet të shtunën në Belfast, ndërsa ndeshjen e fundit veri-irlandezët do të kenë punë me Greqinë.

Donjeta Sadiku kualifikohet në finale

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Pas fitores që e arriti të martën ndaj ish-kampiones së Evropës, francezes Maiva Hamadouche, boksiera e Kosovës, Donjeta Sadiku, të mërkurën triumfoi ndaj zviceranes Ana Milisic dhe u kualifikua në finale të turneut ndërkombëtar të boksit Balkan që po mbahet në Sofje të Bullgarisë, kategoria 60 kg. Bursistja olimpikë "Paris 2024" po shfaq formë të lartë para Kampionatit Evropian që mbahet muajin e ardhshëm në Budva të Malit të Zi.



FShF-ja jep 300 mijë euro shpërblim për kuqezinjtë nëse fitojmë në Izrael

TIRANË, 21 SHTATOR - Kombëtarja shqiptare është duke vijuar përgatitjet për dy ndeshjet e fundit në Ligën e Kombeve teksa do të kërkohet dhe mrekullia për ta marrë vendin e parë. Të shtunën kuqezinjtë do të luajnë me Izraelin në transfertë, një duel vendimtar. Për ta përforcuar

rëndësinë që ka kjo ndeshje për kuqezinjtë Komiteti Ekzekutiv ka vendosur 300 mijë euro shpërblim për fitoren e këtij takimi. Lajmi është konfirmuar nga burime pranë FShF-së. Triumfi në Ligën B shton ndjeshëm shanset për një kualifikim të mundshëm për në

Evropianin e ardhshëm. Për momentin situata në grupin tonë është e tillë: Izraeli kryeson me 5 pikë, Islanda ka 3 pikë dhe Shqipëria vetëm 1 pikë. Një sukses i mundshëm në Izrael do t'i mbante gjallë shpresat tona për një vend të parë që do të ishte shumë domethënës.



Zbulohen detaje të reja nga vdekja e futbollistit Sala

LONDËR, 21 SHTATOR - Vdekja e Emiliano Salas tronditi mbarë opinionin sportiv dhe jo vetëm në janar të vitit 2019. Së fundmi, "BBC" ka nxjerrë në dritë detaje të reja për ndarjen nga jeta të sulmuesit argjentinas, i cili ishte duke udhëtuar nga Nantes në Francë për ta kompletuar transferimin e

tij tek ekipi i Cardiffit. Avioni i tij u rrëzua në mënyrë të mistershme në zonën e quajtur "Kanali i La-Manshit". Pas disa ditësh kërkimesh, trupi i argjentinasit u gjend, ndërsa i pilotit ende në ditët e sotme nuk është gjendur. "BBC" ka publikuar një audio ku piloti i avionit ka

folur me miqtë e tij ku deklaroi se ka dëgjuar një zhurmë në avion dhe se do ta vishte menjëherë jelekun e shpëtimit për të qenë i sigurt. Emiliano Sala ndërroi jetë në moshën 29-vjeçare teksa ëndërronte të kishte një aventurë të re në Angli me fanellën e Cardiffit në janar të vitit 2019.



Cikalleshi: Ndaj Izraelit na bëjnë punë vetëm tri pikët

TIRANË, 21 SHTATOR - Sokol Cikalleshi ka folur para medieve në prag të ndeshjes ndaj Izraelit dhe Islandës për Ligën e Kombeve, përballje që duhen fituar për ta siguruar kreun e Grupit B të Ligës 2 në Ligën e Kombeve. "Po punojmë shumë, po bëjmë më të mirën për momentin, edhe pse grupi nuk është i plotë. Shpresojmë ta marrim rezultatin që na çon në realizimin e objektivave. Më mirë është të luaj me dy sulmues, kur kam një partner afër mundësia e shënimit është më e madhe. Besoj kështu do të vazhdojmë të luajmë. Rëndësi ka që të jetë grupi i plotë. Problemi i ndeshjes së fundit ishin gabimet që mund të evitoheshin. Kemi bërë analiza me video, i kemi parë gabimet dhe besoj do t'i përmirësojmë", ka thënë Cikalleshi. "Izraeli? Kundërshtar i vështirë, grup më i vështirë se përpara. Të bëjmë më të mirën taktikisht. Të mos pësojmë dhe më pas të shohim për të shënuar e



fituar. Na bëjnë punë vetëm tri pikët në Izrael. Po tentoj të provoj një aventurë të re, kam dy vjet kontratë me Konyasporin, mund të rikthehem përsëri aty pas një viti. Do të jem gjithmonë i gatshëm për Kombëtaren. Jam pak larg, kampionati nuk është si

në Turqi. Mendoj se ftesa e Kombëtares nuk do të më mungojë. Është kampionat i ri. Shpresoj të përshtatem sa më shpejt dhe të shënoj. Nëse arrij në formë besoj se do ta ndihmoj edhe kombëtaren", ka deklaruar Cikalleshi.

LeBroni mbledh lojtarët e Lakersit në shtëpinë e tij për një fazë përgatitore private

LOS ANXHELOS, 21 SHTATOR - Pas zhgënjimit të sezonit të kaluar, ku lakersat nuk arritën të kualifikohen në fazën "play-off" në NBA, këtë vit pritshmëritë janë të mëdha të skuadra kaliforniane. Dhe kapiteni i këtij ekipi, LeBron James, nuk dëshiron të dështojë sërish. Ndaj në këtë fundjavë ai do të mbledhë në shtëpinë e tij në San Diego të gjithë skuadrën e Lakersit. Pa përgjatim! Përfshirë edhe Russell Westbrookun, që mendohet të largohet, por nuk ka asgjë të sigurt. Skuadra do të zhvillojë një mini-fazë përgatitore 2-3 ditore sekrete, ku më së shumti do të diskutohet e flitet mes lojtarëve për t'i arritur objektivat. Në këtë grumbullim nuk do të jetë asnjë nga stafi drejtues, por vetëm lojtarët. Duket



se LeBron Jamesi kërkon ta bashkojë skuadrën para fillimit të sezonit të ri, duke krijuar unitet mes lojtarëve. Prezantimi zyrtar i

lakersave do të bëhet më 26 shtator, kur dhe nis faza përgatitore zyrtare e skuadrave të NBA-s.

SHKURT

Granit Dervisholli, trajner i ri i Ramiz Sadikut

KF Ramiz Sadiku e ka paraqitur trajnerin e ri, Granit Dervisholli. Ky i fundit e ka mbajtur edhe stërvitjen e parë me ekipin e seniorëve. Skuadra kryeqytetase e ka falënderuar trajnerin e larguar Triumf Sinani për punën e bërë në klub. "Granit Dervisholli merr timonin e ekipit së seniorëve. Trajneri i ri bashkë me stafin e tij kanë mbajtur treningun e parë me ekipin dhe janë ndarë shumë të kënaqur me dëshirën dhe motivin e treguar gjatë treningut të parë. Falënderojmë trajnerin Triumf Sinani bashkë me stafin e tij për punën e bërë deri më tani. Vazhdojmë të bashkuar drejt synimeve tona", thuhet në njoftimin Ramiz Sadikut.

Portieri i Trepçës '89 grumbullohet me Kombëtaren e Kongos

Portieri i skuadrës së Trepçës '89, Marly Prince, është grumbulluar me Kombëtaren e Kongos. Lajmin e ka bërë me dije skuadra nga Mitrovica në faqen e vet zyrtare në "Facebook". "Marly Prince, gardiani i portës sonë, është grumbulluar me ekipin kombëtar të Kongos. Prince tani është bashkuar me ekipin në Moroko ku dhe do t'i zhvillojnë ndeshjet e tyre. Ne i urojmë sukses në paraqitjet e tij", thuhet në njoftimin e 89-shit.

Canavaro merr drejtimin e Beneventos

Ish-mbrojtësi i Kombëtares së Italisë, Fabio Canavaro, është emëruar trajner i Beneventos. Lajmin e ka dhënë vetë klubi në rrjetet sociale. Ish-mbrojtësi ka nënshkruar kontratë dyvjeçare që do ta mbajë atë në klub deri në vitin 2024. Kjo është përvoja e parë e ish-fituesit të "Topit të Artë" si trajner.

Bayerni, nëse nuk e transferon Kanen, synon Martinezin

Bayern Muncheni po planifikon që në të ardhmen ta ketë në skuadër sulmuesin aktual të Tottenham Hotspurit, Harry Kane. Mirëpo nëse dështon realizimi i këtij transferimi, atëherë kampionët e Gjermanisë e kanë bërë edhe planin b, i cili është transferimi i sulmuesit të Interit, Lautaro Martinez. 25-vjeçari pëlqehet shumë nga drejtuesit e Bayernit të cilët po planifikojnë afrimin e tij në verën e vitit ardhshëm. Lautaro ka një kontratë me Interin deri në verën e vitit 2026, derisa "bavarezët" janë gati të shpenzojnë deri në 100 milionë euro për transferimin e tij.

Benzema, afër rinovimit të kontratës me Realin

Real Madridi është afër finalizimit të rinovimit të kontratës me sulmuesin Karim Benzemas, raporton "T o d o f i c h a j e s". Reprzentuesi francez është

bërë që nga largimi i Cristiano Ronaldos lideri i vërtetë i skuadrës dhe në moshën 34-vjeçare ai ka ende shumë për të dhënë. Fillimisht ishte përfolur se

bardhezinjtë e kishin ofruar deri në vitin 2024, por më në fund duket se lojtari ia ka arritur qëllimit për ta rinovuar qëndrimin edhe për një sezon. Në këtë

mënyrë, Benzema do të sigurojë që të vazhdojë ta mbajë veshur fanellën e bardhë të paktën derisa të mbushë 36 vjeç dhe kërcënon të mbetet një lojtar

kyç në skemat e Carlo Ancelottit. Marrëveshjes i mungojnë vetëm disa detaje dhe ideja është që të zyrtarizohet para Kupës së Botës në Katar.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 21.09.2022 bënë shpallje publike për dhënie me qira te pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike

T-22-06

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e fushës së futbollit - Kishnic
Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë
Data e shpalljes: 21.09.2022
Sqarimi: deri me 30.09.2022
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 04.10.2022
Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur)
Afati i fundit i dorëzimit: 05.10.2022 në 15:00
Vendi i dorëzimit: Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku inustrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>sales@trepcacorporation.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepcacorporation.com</i>		

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Gashi Rent 2022” - Sh.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811969595 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Gashi Rent 2022 - d.o.o., donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811969595 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that “Gashi Rent 2022” - L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 811969595, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Vjosë Jetullah Sermahaj shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara të Biznesit (Shkolla e Biznesit) Pejë.
- Roland Isufi nga Beci i KK Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. Ahmet Rrustemi-Bec, KK Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.
- Albulena Zuka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X, XI, XII, XIII dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Edonis Gashi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. së dhjetë të shkollës së mesme profesional “Prenk Jakova” Prishtinë.
- Dr. Qamile Morina shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës me nr: KO-00549-01-01.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ABC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A. Paraguay, Quality
- ★ Fábrica de Bebidas Casseiras Salvadorenas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fuzuli Sijupak, Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Fuzada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zolal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Pariza Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales